| | | | | Ju mund të aplikoni për këtë shërbim online përmes platformës qeveritare e-Albania në linkun: [https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9444](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9444)<br>Kërkoni shërbimin "Aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë me anë të ligjit me vendim të gjykatës apo të një akti administrativ" dhe aplikoni duke plotësuar formularin elektronik që shfaqet në platformë dhe duke ngarkuar dokumentacionin e nevojshëm për lëvrimin e shërbimit.<br>Në hapin e dytë shtohen automatikisht edhe këto shërbime: L1- Lëshim certifikate pronësie; I5- Lëshim kopje kartele te pasurisë; I4- Lëshim kopje te fragmentit te hartës kadastrale. Dokumentacioni i nevojshëm për t`u ngarkuar është AMTP, certifikate familjare ne daten 01.08.1991. Plan rilevimi. AMTP dhe çdo document tjetër që duhet të ngarkohet në të gjitha rubrikat e detyrueshme në hapin e tretë.<br>Pamvaresisht se si i kane emertimet dokumentat qe duhen ngarkuar ne hapin e trete, do te ngarkoni dokumentat qe keni. Aplikimi për regjistrimin e AMTP dhe pajisjes me certifikatë pronësie nuk penalizohet me gjobë, por kujdes! Në hapin e tretë, si datë lëshimi të dokumentit do të vendosni datën e kryerjes së aplikimit të mësipërm. Në fund klikoni opsionin "*Dërgo*".<br>Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën ose kryeni pagesën online përmes portalit e-Albania me një kartë debiti ose kredit. Nëse pagesa kryhet në bankë ose postë, duhet që t`i riktheheni edhe njëherë aplikimit për të ngarkuar mandatpagesën.<br>Ngarkimi i mandatpagesës: Duhet të logoheni në e-Albania dhe të kërkoni shërbimin e aplikuar. Nuk do të kryeni aplikim të ri por do të shkoni në fund të formularit, në seksionin *"Dërgo mandat-pagesën e një aplikimi të kryer"*.<br>Plotësoni të gjitha fushat, numrin e referencës së aplikimit e gjeni edhe tek *"Mesazhet e mia"*, ngarkoni faturën dhe më pas klikoni "*Dërgo*". Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | | |
| 44 | 18.04.2023 | Kërkesë për informacion për korrigjim të | 18.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se ju mund të bëni një aplikim AV0 për të kërkuar korrigjimin e gabimit në kartelën e pasurisë. Për të plotësuar një AV ose e quajtur ndryshe "Akt | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kartelës së pasurisë | | Verifikimi" ju duhet të logoheni me të dhënat tuaja në e-Albania dhe më pas të kërkoni shërbimin që ju keni aplikuar së fundmi, shërbim për të cilin do të plotësoni dokumentacionin me AV. Pas kërkimit të shërbimit ju duhet të klikoni "Përdor" dhe më pas do të vazhdoni në fund të faqes ku do të gjeni një tabelë me këtë pamje: https://tawk.link/5e80ea4d35bcbb0c9aab9fb8/a/5e8107fc28df9e0edc53ae23/c10ccb4e33d6cf97a314fb04d859ed7a3be2b411/ploteso_av.JPG Aty ku thote ngarko dokumentin AV, ju do te ngarkoni nje kerkese me shkrim ku kerkoni te korrigjohet gabimi ne kartelen tuaj te pasurise. Pasi të plotësoni të dhënat e mësipërme, klikoni butonin "Dërgo". Ky dokument (AV) është kërkesa ose shkresa juaj që do ia drejtoni ASHK-së. Për cdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanalin informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në te premte ne fashen orare 08.00 – 19.00. | | |
| 45 | 18.04.2023 | Kërkesë për informacion për pension pleqërie | 18.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nevojiten 45 dite te plota pune per te shqyrtuar Kerkesat per Pension Pleqerie. Nese ju keni aplikuar dhe eshte permbushur afati prej 45 ditesh, ju lutemi te adresoni ankesen tuaj prane portalit te https://www.shqiperiaqeduam.al/ . Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 46 | 18.04.2023 | Kërkesë për informacion për korrigjim të dhënash në certifikatën familjare | 19.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se lidhur me problemin që referoni, lutemi dergoni email në adresën e suportit të e-albania: helpdesk@e-albania.al . Referoni problematikën dhe bashkëlidhni dokumentin certifikatë familjare që keni shkarkuar nga sistemi. Nëse dispononi ndonjë certifikatë të mëparshme ku të dhënat janë të sakta, mund ta paraqisni si provë apo dokument justifikues. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 47 | 18.04.2023 | Kërkesë për informacion për gjenerim passwordi | 19.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk keni aktive asnjë nga të dhënat e regjistrimit(adresë email dhe numër telefoni) për të gjeneruar një pasword të ri duhet të veproni si më poshtë: | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Hapni një adresë të re email dhe dërgoni këto të dhëna në adresën: helpdesk@e-albania.al : - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - datëlindja e nënës. Specifikoni adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 48 | 19.04.2023 | Kërkesë për informacion për certifikatë pronësie | 19.04.2023 | Përshëndetje z. Cobani, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Pershendetje, Para disa javes bera nje aplikim per (Certificate pronesie) dhe mu kerkua nga ana e portalit e-albania saktesim pronesie per aplikimin,I dergova nje FOTO nga kartela qe Ka mare vellai qe eshte edhe bashkepronar ne kete pasuri,ju lutem te me informoni ne lidhje me statusin e aplikimit,pasi ne e-albania eshte ne status ne procesim ke sekretaria e regjistruesit,Jam ne pritje te pergjigjes suaj. Duke ju falenderuar. | E deleguar | Nuk ka |
| 49 | 19.04.2023 | Kërkesë e paplotë për informacion | 20.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se kerkesa juaj eshte e paplote. Ju nuk keni specifikuar statusin e biznesit tuaj. Per kete arsye, na kontaktoni në kanalet tona te komunikimit, ne numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 per te na specifikuar me tej llojin e biznesit tuaj, ne menyre qe te mund tju orjentojme lidhur me sherbimet. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 50 | 19.04.2023 | Kërkesë e paplotë për informacion | 20.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se kërkesa juaj është e paqartë, pasi ju nuk keni specifikuar nëse keni kryer pagesat në bankë për përfitimin e shërbimeve. Megjithate, për shërbimet që janë me pagesë në portalin e-albania, cdo aplikant duhet të shkarkoj dokumentin e mandatit të pagesës për shërbimin që aplikon dhe duhet të kryej pagesën pranë bankës. Gjithashtu ne varesi te sherbimit, ju duhet ti dërgoni dokumentat edhe me postë pranë ZVRPP-se përkatëse bashkelidhur me numrin e aplikimit tuaj. Kjo varet nga lloji i sherbimit! Gjithsesi, ju lutemi | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00., per tju sqaruar me tej per rastin tuaj. Faleminderit! | | |
| 51 | 20.04.2023 | Kërkesw e paplotë për informacion | 20.04.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se qe te mund tju ndihmojme me problematiken tuaj ju duhet te na dergoni dokumentin e plote me foto. Per kete arsye, na kontaktoni në online chat, nga e hëna në te premte ne fashen orare 08.00 – 19.00 dhe na dergoni dokumentin e plote me foto ne menyre qe te mund tju orjentojme sakte per kerkesen tuaj. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 52 | 20.04.2023 | Kërkesë e paplotë për informacion | 20.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se qe te mund tju ndihmojme me problematiken tuaj Na duhet te dijme nese ju e keni femijen ne certifikaten tuaj familjare. Ju lutemi na kontaktoni ne chatbox online , https://www.adisa.gov.al/ dhe na dergoni me foto dokumentin e certifikates familjare ta shohim, ne menyre qe te mund t'u ndihmojme me problematiken tuaj. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 53 | 20.04.2023 | Kërkesë për informacion për Dëshmi Aftësie Drejtimi për Mjetet e Vogla Lundruese | 20.04.2023 | Përshëndetje, Duke qene se kerkesa juaj për informacion është specifike, Ju lutemi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 për tju sqaruar më tej për rastin tuaj. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 54 | 20.04.2023 | Kërkesë për informacion për lidhje martese midis dy shtetasve shqiptarë | 24.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se fillimisht duhet të kryeni shpalljen e martesës. Procedura për të bërë shpalljen e martesës mes dy shtetasve shqiptar në Republikën e Shqipërisë është si më poshtë vijon : Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa. Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë:prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes;certifikatë lindje, me shënimin "për shpallje martese";fotokopje e dokumentit të identifikimit;Martesa nuk mund të | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afatii vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, secili nga bashkëshortët e ardhshëm<br>pajiset me dokumentin certifikatë lindje për lidhje martese. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy dëshmitarë.<br>Pra. lidhur me pyetjet tuaja, ju mund ti jepni prokurë një personi në Shqipëri për të kryer procedurat e shpalljes për ju dhe të fejuarin tuaj. Ky person do shkoj në institucione të mbledh dokumentat për ju. Pasi kalojnë 10 ditë nga shpallja e martesës, ju dhe bashkeshorti juaj pajiseni me certifikatë lindje për lidhje martese, prej nga caktoni datën e lidhjes së martesës dhe ditën e martesës merrni dhe dy dëshmitarë. Lidhur me pyetjen sa zgjat procedura derisa të merrni certifikim martesor, Ju mund të caktoni datën më të afërt për lidhjen e martesës tuaj, 10 ditë pas shpalljes. Gjithsesi, për cdo paqartësi ju lutemi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ose ne chatbox online ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/ . Faleminderit! | | |
| 55 | 22.04.2023 | Kërkesë për informacion për përfitim të passaportës shqiptare nga shtetas I huaj | 24.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se dokumentat për të përfituar passaportë shqiptare janë: 1. Kërkesa e shtetasit të huaj drejtuar Presidentit të Republikës 2. Çertifikata e lindjes (origjinale me vulë Apostile ose legalizim në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në vendin ku është lëshuar dokumenti 3. Çertifikatë martese (origjinale me vulë Apostile ose legalizim në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në vendin ku është lëshuar dokumenti;<br>4. Lejeqëndrimi në Republikën e Shqipërisë (Leje-qëndrimi 5 vjeçare, për të gjithë shtetasit e huaj, Leje-qëndrimi 3 vjeçare, për ata të huaj që vertetojnë origjinën shqiptare deri në dy shkallë, qoftë edhe nga njëri prind, (me certifikatë ku të pasqyrohet shtetësia shqiptare e të paralindurit), Leje-qëndrimi 1 vjeçare, për ata të huaj të martuar me shtetas shqiptar, por jo më pak se tre vjet martese). 5. Akti i pronësisë së banesës ose kontrata e qirasë së të banesës në Republikën e Shqipërisë (fotokopje e noteruar). 6. Kontratë pune për të punësuarit ose vërtetim nga Zyra e Tatimeve për të vetëpunësuarit (fotokopje e noterizuar). 7. Dokumenta që vërtetojnë disponimin e mjeteve | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | financiare të mjaftueshme për jetesë (si garanci bankare, librezë kursimi, vërtetime zyrtare të ardhurash në Republikën e Shqipërisë).<br>8. Dëshmi penaliteti e marrë në vendin e origjinës (origjinale me vulë Apostile ose legalizim në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në vendin ku është lëshuar dokumenti 9. Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore në Republikën e Shqipërisë; 10. Fotografi (copë 3) Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ose na kontaktoni ne chatbox online ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/ Faleminderit! | | |
| 56 | 22.04.2023 | Kërkesë për informacion për certifikatë trungu familjar | 24.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se, Per qytetaret e Tiranes, certifikatat merren tek Bashkia Tirane. Per rrethinat e Tiranes merren tek Prefektura Tirane. Per te gjitha Bashkite e Komunat e tjera ne territorin e Shqiperise, certifikatat merren prane Prefekturave te Qarqeve respektive. Ju qe jetoni ne Itali mund te beni prokure nje te afermit tuaj qe rri ne Shqiperi dhe ne kete menyre mund te drejtohet ai ne institucion me kerkesen tuaj. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 57 | 22.04.2023 | Kërkesë për informacion për ndërtim në kufi të pronës | 24.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, duke qene se kerkesa juaj per informacion eshte specifike, ju lutemi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ose ne chatbox online ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/ .Keshtu ne mund tju sqarojme me mire per pyetjen tuaj. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 58 | 23.04.2023 | Kërkesë për informacion për përfitimin e shtetësisë shqiptare | 24.04.2023 | Hello,According to you question, you cannot stay abroad for more than 180 days. Also, remember that the reason why you travel abroad has to be justified. For any other questions please contact us on our chatbox online at our official page https://www.adisa.gov.al/ Thank you! | E plotë | Nuk ka |
| 59 | 24.04.2023 | Kërkesë për informacion pwr përfitimin e | 24.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjme me dije se për të marrë certifikatë lindje, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin " Aplikim për certifikatë lindje" në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9485 | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | certifikatës së lindjes | | Pas verifikimeve të nevojshme të kryera nga përfaqësues të ambasadës/konsullatës, pranohet aplikimi dhe aplikanti ftohet më pas të ndjekë procedurat për të kryer pagesën dhe për të dërguar mandatin origjinal (jo fotokopje) me postë. Kthimi i përgjigjes kryhet me e-mail tek qytetari dhe njoftohet gjithashtu për dërgimin e certifikatës së lindjes me postë në adresën e tij. Dokumentacioni i nevojshëm *Dokumente që ngarkohen nga aplikanti:*<br>- Dokument identifikimi (Pasaportë ose kartë identiteti shqiptare);<br>- Kartë identiteti e shtetit rezident, ku shënohet vendbanimi ose certifikatë rezidence lëshuar nga komuna ose deklaratë personale për vendbanimin e lëshuar nga komuna ose kopje kontrate banimi e vlefshme jo më pak se 12 muaj (e noterizuar). Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | | |
| 60 | 24.04.2023 | Kërkesë për informacion për Pagesën e taksës vjetore të mjetit | 24.04.2023 | Përshëndetje, Ne vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjme me dije se për të paguar taksën vjetore të mjetit, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin, Pagesa e taksës vjetore të mjeteve të përdoruara/ mjeteve të luksit, në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=772<br>Në rastin kur shërbimi shfaq: "Nuk ka të dhëna!", arsyet e mos shfaqjes së të dhënave janë: - Nuk ka automjete të regjistruara në pronësi të qytetarit ose biznesit; - Ekzistojnë raste kur ka automjete të regjistruara në pronësi të qytetarit ose biznesit, por në të dhënat e pronarit nuk është i regjistruar Numri i Identifikimit të tij (NID); - Nuk keni kryer proçedurën e ndërrimit të pronësisë referuar një dokumenti të fitimit të pronësisë. Në këto raste, lutemi që të drejtoheni pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor për plotësimin e të dhënave tuaja në regjistrin elektronik të DPSHTRR-së. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 61 | 24.04.2023 | Kërkesë për informacion për | 24.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjme me dije se: Karta e memories tahograf lëshohet nga DPSHTRR-ja nëse kërkuesi: ka vendqëndrimin e tij në Shqipëri; është mbajtës i një leje drejtimi të vlefshme e | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Kartë tahografi për drejtues mjeti | | cila mundëson drejtimin e një mjeti që i nënshtrohet marrëveshjes europiane AETR ose Rregullores së miratuar me VKM Nr.1243, datë 10.09.2008; nuk ka kartë tahografi drejtuesi të vlefshme, por ka bërë një kërkesë që është në shqyrtim.  Aplikimi për pajisje me kartë memorie tahograf  Aplikimi për kartë memorie tahograf bëhet pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor (DRSHTRR-së) ku keni vendbanimin duke dorëzuar dokumentet e mëposhtme:  Mjet identifikimi;  Lejen e drejtimit që zotëron;  Një fotografi;  Karta memories tahograf e drejtuesit të mjetit nuk mund të zëvendësojë në asnjë rast Lejen e Drejtimit, ajo duhet të paraqitet gjatë çdo kontrolli.  Karta tahograf e drejtuesit të mjetit është personale. Drejtuesi i mjetit mbetet zotërues i kartës tahograf në çdo rast të ndryshimit të punëdhënësit.  Karta s'mund të jetë, gjatë vlefshmërisë së saj, objekt heqjeje apo pezullimi për çfarëdolloj arsyeje, përveçse kur autoriteti kompetent i një shteti anëtar konstaton se karta është e fallsifikuar, kur drejtuesi i mjetit përdor një kartë që nuk është e tij ose që karta është marrë mbi bazën e deklaratave të rreme dhe/ose dokumenteve të fallsifikuar.  Humbja dhe vjedhja e Kartës së Tahografit  Në rast humbje apo vjedhje, mbajtësi duhet të bëjë një denoncim pranë autoriteteve kompetente të shtetit ku ka ndodhur humbja apo vjedhja. Nëse aplikanti ka vendbanimin në një shtet tjetër nga ai që ka lëshuar kartën, deklarata e humbjes duhet të bëhet pranë autoritetit kompetent të shtetit ku ai banon. Pasi të konfirmohet mbërritja e denoncimit në DRSHTRR, depozitohet aplikimi për kartë të re me dokumentet përkatëse.  Aplikimi për ndërrim të kartës së memories tahograf Drejtuesi i mjetit, nëse dëshiron, mund të aplikojë për një ndërrim të kartës së memories gjatë periudhës së vlefshmërisë vetëm sipas rasteve të parashikuara si më poshtë:  1. Në rast të ndryshimit të shtetit të vendbanimit ai duhet ti kërkojë subjektit të autorizuar ose licensuar të vendbanimit të ri një kartë të re, duke dorëzuar kartën e tij e cila është brenda periudhës së vlefshmërisë.  2. Në rast të ndryshimit të të dhënave administrative që figurojnë në Lejen e Drejtimit, mbajtësi bën një kërkesë për kartë tahograf pranë DRSHTRR-së duke kthyer kartën që është brenda periudhës së vlefshmërisë.  Në rast ndërrimi të kartës, karta e re e lëshuar ka një kohëzgjatje vlefshmërie prej 5 vitesh duke filluar nga data e lëshimit. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Kthimi i kartës së memories tahograf Mbajtësi mund ta kthejë kartën tahograf në çdo moment dhe pa paralajmërim. Kthimi i kartës shoqërohet dhe me një deklaratë personale në prani të nëpunësit të DRSHTRR-së, e cila administrohet në dosje së bashku me kartën, dhe kjo e fundit bëhet e pavlefshme. Çdo kërkesë e re përbën objektin e krijimit të një aplikimi të ri. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit. | | |
| 62 | 24.04.2023 | Kërkesë për informacion për Aplikim për regjistrimin fillestar të shoqërive të huaja | 24.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjme me dije se: Ju duhet te beni nje Aplikim për regjistrimin fillestar të degëve ose zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja:https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=15188 Gjatw aplikimit ju do te deklaroni edhe fushen ne te cilen operoni. Ne brendesi te aplikimit do te gjeni Kodet NVE (nomeklatura e veprimtarise ekonomike). Ne linkun me poshte do gjeni manualin dhe dokumentacionin: https://e-albania.al/dokumenta/qkr/MANUALI_SHOQERIVE_HUAJA.pdf | E plotë | Nuk ka |
| 63 | 24.04.2023 | Kërkesë për informacion për Përfitimin e Pagesës së Shpenzimeve të zbritëshme në rast sëmundje | 24.04.2023 | Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Pershendetje, Kam kerkuar 1 informacion te sakte tek Sigrimeve Shoqerore mbi procedurat dhe dokumentacionin e nevojshem per Përfitimin e Pageses se Shpenzimeve te zbritëshme per mjekimin e femijes tim jashte vendit. Por Sigurimet Shoqerore me jane pergjigjur ndoshta Fondi të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor, mund te me japi pergjigjen qe kerkoj... Ju lutem mund te kem 1 pergjigje nga istitucioni perkates? Bashkengjitur keni emailin tim dhe pergjigjen e Sigurimeve Shoqerore.Ju faleminderit! | E Deleguar | Nuk ka |
| 64 | 24.04.2023 | Kërkesë për informacion për | 25.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, ju mund të drejtoheni pranë Portalit Me Ty Për Shqipërinë Që Duam, | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | certifikatë pronësie | | në mënyrë që të drejtoni ankesën tuaj në seksionin ANKESA IME. Bashkëlidhur gjeni linkun për tu drejtuar në portal: https://www.shqiperiaqeduam.al/ Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 65 | 24.04.2023 | Kërkesë për informacion për certifikatë trungu familjar | 25.04.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se ju duhet të adresoheni pranë perfekturës së qarkut ku ka qënë familja në vitin 1992. Nëse e keni të pamundur të shkoni vet, mund të bëni një prokurë ku të autorizoni një të afërmin tuaj në Shqipëri që ta marrë certifikatën per ju. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ose na kontaktoni ne chatbox online ne faqen tone zyrtare, https://www.adisa.gov.al/.Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 66 | 25.04.2023 | Kërkesë për informacion për certifikatë trungu familjar | 25.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Certifikatat e Trungut Familjar nuk mundësohen në e-albania. Për këto certifikata, procedohet si më poshtë: Për qytetaret e Tiranës, certifikatat merren tek Bashkia Tiranë. Për rrethinat e Tiranës merren tek Prefektura Tiranë.Për të gjitha Bashkitë e Komunat e tjera në territorin e Shqiperisë, certifikatat merren pranë Prefekturave të Qarqeve respektive. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 67 | 25.04.2023 | Kërkesë për informacion për Regjistrimi i individit në e-albania | 25.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se: Regjistrimi në portalin qeveritar e-Albania mund të kryhet si për shtetasit shqiptarë, ashtu dhe për shtetasit e huaj të pajisur me leje qëndrimi në Shqipëri. Shtetasit shqiptarë regjistrohen nëpërmjet Numrit Personal të Identifikimit, të cilin e gjejnë në kartën e tyre të identitetit. Pasi të jetë hapur portali www.e-albania.al duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm: Klikoni "Regjistrohu/Register" Plotësoni të gjitha të dhënat e specifikuara në formularin e regjistrimit, Kodi i përdoruesit (NID: Numri personal i identifikimit) / User Personal Identification Number (NID) : Është numri personal i identifikimit.Data e skadimit të kartës së identitetit / Identification document expiry date: Vendosni datën e skadimit të kartës së identitetit në | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | formatin datë.muaj.vit. Fjalëkalimi / Password: Sigurohuni që fjalëkalimi të jetë 8 deri në 12 karaktere i gjatë dhe nuk duhet të fillojë ose mbarojë me hapësira. E-mail: Në këtë adresë do të vijë linku i aktivizimit të llogarisë dhe të gjitha njoftimet që kanë te bëjnë me aplikimet tuaja. Numri i celularit / Mobile phone number: Sigurohuni që të vendoset në formatin e duhur. Për numrat shqiptarë formati është '06xxxxxxxx' ndersa për numrat jashtë Shqipërisë, formati i saktë është '0044/0039/0032xxxxxxxx', në varësi të shtetit ku jetoni. Të dhënat personale (Emri / Name, Mbiemri / Surname, Atësia / Father Name, Mëmësia / Mother Name, Datëlindja / Birthdate): Duhet të bëhet kujdes që të gjitha të dhënat të jenë të sakta dhe të përputhen më të dhënat e Regjistrit të Gjendjes Civile * *Kujdes me të dhënat që mund të kenë "ë", ose "ç".* Nëse edhe pas verifikimit të të dhënave tuaja në Gjendjen Civle do të keni vështirësi me regjistrimin kontaktoni ne adresen : helpdesk@e-albania.al. Plotësoni kodin katër shifror të dërguar me SMS në numrin tuaj të telefonit dhe klikoni në linkun e aktivizimit në adresën tuaj e-mail për aktivizimin e llogarisë tuaj. Lidhur me faktin se karta juaj e identitetit ka skaduar, nuk përbën problem ky fakt për procesin e regjistrimit në e-albania. Vendosni datën e skadencës ashtu siç e keni në kartë. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit! | | |
| 68 | 25.04.2023 | Kërkesë për informacion për lidhje martese me shtetas të huaj | 25.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar:-certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile;<br>-dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese); -dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj;fotokopje e dokumentit të identifikimit. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ose na | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kontaktoni ne chatbox online ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/ .Faleminderit! | | |
| 69 | 25.04.2023 | Kërkesë e paplotë për informacion | 25.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se kërkesa juaj është e paqartë, pasi nuk keni sqaruar llojin e kërkesës që ju kanë bërë, as procedurat qe keni ndjekur për perfitimin e certifikatës së pronësisë. Ju lutemi për tju sqaruar na kontaktoni ne chatbox online ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/ . Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 70 | 25.04.2023 | Kërkesë për informacion për pasuri të paluajtshme | 26.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se, në rastin tuaj, ju mund të kryeni një Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë) pranë portalit e-albania, prej nga muund ti drejtoni hipotekës një kërkesë me shkrim ku te shpjegoni rastin tuaj dhe ti pyesni si mund të procedoni. Hapat e procedures: - Identifikohuni si qytetar ose si biznes në portal - Zgjidhni shërbimin " Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe institucionet" - Klikoni butonin "Përdor" - Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme mbi pronën, shërbimin/shërbimet e kërkuara dhe taksat e nevojshme - Klikoni butonin "Dërgo" në faqen e fundit të formularit<br>- Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën ose kryeni pagesën online përmes portalit e-Albania me një kartë debiti ose krediti; - Punonjësi i ASHK-së proceson kërkesën e ardhur dhe në varësi të vendimit që merret i kthen përgjigje me e-mail aplikuesit, me URL-në e shkarkimit të përgjigjes elektronike të ruajtur tek "Dokumentet e mia" në e-Albania. * Pas kryerjes së aplikimit ju nuk duhet të prisni shërbimin postar për kthim-përgjigjen e aplikimit të kryer, por do të mund të merrni përgjigjen me vulë dhe firmë elektronike tek "Dokumentat e Mia" në profilin tuaj në e-Albania. Kostot: 2000 lekë. Kujdes! Dokumentin me kerkesen tuaj ngarkojeni ne format PDF duke perfshire te gjithe informacionin qe kerkoni te merrni. Me pas Kerkesen tuaj se bashku me faturen e gjeneruar nga sistemi, te printuara, dergojini me Poste prane ASHK dhe prisni pergjigjen zyrtare qe do t'ju vij ne llogarine tuaj ne portalin e-albania. Bashkëlidhur do të gjeni linkun për shërbimin: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477 Për cdo | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 71 | 26.04.2023 | Rregjistrimi i individit në portalin e-albania | 26.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se: Regjistrimi në portalin qeveritar e-Albania mund të kryhet si për shtetasit shqiptarë, ashtu dhe për shtetasit e huaj të pajisur me leje qëndrimi në Shqipëri. Shtetasit shqiptarë regjistrohen nëpërmjet Numrit Personal të Identifikimit, të cilin e gjejnë në kartën e tyre të identitetit. Pasi të jetë hapur portali www.e-albania.al duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm: a. Klikoni "Regjistrohu/Register" b. Plotësoni të gjitha të dhënat e specifikuara në formularin e regjistrimit c. Kodi i përdoruesit (NID: Numri personal i identifikimit) / User Personal Identification Number (NID) : Është numri personal i identifikimit. d. Data e skadimit të kartës së identitetit / Identification document expiry date: Vendosni datën e skadimit të kartës së identitetit në formatin datë.muaj.vit. e. Fjalëkalimi / Password: Sigurohuni që fjalëkalimi të jetë 8 deri në 12 karaktere i gjatë dhe nuk duhet të fillojë ose mbarojë me hapësira. f. E-mail: Në këtë adresë do të vijë linku i aktivizimit të llogarisë dhe të gjitha njoftimet që kanë te bëjnë me aplikimet tuaja. g. Numri i celularit / Mobile phone number: Sigurohuni që të vendoset në formatin e duhur. Për numrat shqiptarë formati është '06xxxxxxxx' ndersa për numrat jashtë Shqipërisë, formati i saktë është '0044/0039/0032xxxxxxxx', në varësi të shtetit ku jetoni. h. Të dhënat personale (Emri / Name, Mbiemri / Surname, Atësia / Father Name, Mëmësia / Mother Name, Datëlindja / Birthdate): Duhet të bëhet kujdes që të gjitha të dhënat të jenë të sakta dhe të përputhen më të dhënat e Regjistrit të Gjendjes Civile. i.* *Kujdes me të dhënat që mund të kenë "ë", ose "ç".* j. Nëse edhe pas verifikimit të të dhënave tuaja në Gjendjen Civle do të keni vështirësi me regjistrimin kontaktoni ne adresen : helpdesk@e-albania.al. k. Plotësoni kodin katër shifror të dërguar me SMS në numrin tuaj të telefonit dhe klikoni në linkun e aktivizimit në adresën tuaj e-mail për aktivizimin e llogarisë tuaj. Lidhur me faktin se karta juaj e identitetit ka skaduar, nuk përbën problem ky fakt për procesin e regjistrimit në e-albania. Vendosni datën e skadencës ashtu siç e keni në kartë. Për cdo pyetje ose | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 72 | 26.04.2023 | Kërkesë për informacion për Akt Verifikimi | 26.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije se për të plotësuar një AV ose e quajtur ndryshe “Akt Verifikimi” ju duhet të logoheni me të dhënat tuaja në e-Albania dhe më pas të kërkoni shërbimin që keni aplikuar së fundmi, shërbim për të cilin do të plotësoni dokumentacionin me AV. Pas kërkimit të shërbimit ju duhet të klikoni “Përdor” dhe më pas do të vazhdoni në fund të faqes ku do të gjeni tabelën si më poshtë. Plotësoni të gjitha të dhënat e nevojshme dhe më pas klikoni " DERGO". Lidhur me pyetjen Tuaj se cfare dokumenti të ngarkoni, ju bëjmë me dije se duhet të ngarkoni dokumentin që citohet në shkresën e ASHK, ku u kërkohet të aplikoni AV0. Nëse nuk keni dokument, ngarkoni në format PDF shkresën e ASHK. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 73 | 26.04.2023 | Kërkesë për informacion për pajisje me leje qëndrimi | 26.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije se Shërbimi elektronik "Kërkesë për leje qëndrimi" u mundëson shtetasve të huaj, që kanë hyrë dhe qëndrojnë në mënyrë të rregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë, të bëjnë një kërkese për t'u pajisur me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë. Pas konfirmimit të plotësimit të kushteve dhe dokumentacionit për të aplikuar për leje qëndrimi nëpërmjet këtij shërbimi, i huaji njoftohet nga autoritetet vendore përgjegjëse për kufirin dhe migracionin në territorin ku ai ka vendosur vendbanimin e tij të përkohshëm, për dërgimin nëpërmjet shërbimit postar, të këtyre dokumenteve: - dokumentacioni origjinal;<br>- dy fotografi, në formatin e pasaportës me sfond të bardhe, të bëra në 6-mujorin e fundit; - mandat pagesë të tarifës së shërbimit (si dhe të masave admistrative (gjobë) të vendosuar për shkelje të afatit të aplikimit për leje qëndrimi); - formularit të printuar dhe nënshkruar nga aplikanti me foton e aplkuar në të; Për të aplikuar për lejen e parë të qëndrimit në Republiken e Shqipërisë, plotesimi i formularit të duhur të aplikimit varet nga motivi i kërkuar i qendrimit në Shqipëri: - Bashkim Familjar me shtetas shqiptar; - Bashkim Familjar me shtetas të huaj të pajisur me leje qëndrimi të vlefshme në Shqipëri; - Studim; - Leje Unike ; - Arsye të tjera; - E Përhershme; - E | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Përhershme për raste të vecanta; Kërkesa on-line për leje qëndrimi pranë autoriteteve rajonale përgjegjëse për kufirin dhe migracionin, duhet të bëhet Brenda 30 ditëve pas hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke u siguruar që aplikanti i huaj: - Në momentin e aplikimit për leje qëndrimi është prezent në territorin e Republikes së Shqiperisë; - Ka qendrim të rregull në territor; - Plotëson afatet dhe kriteret ligjore për tipin e lejes e qëndrimit për të cilën po aplikon sipas legjislacionit në fuqi për të huajt; - Ka të gjitha dokumentet e nevojshme, dokumentet nga vendi i origjinës të përkthyera dhe legalizuara; - Ka nje adrese personale e-mail nëpërmjet së cilës do të kryhet komunikimi on-line me Autoritetin për Kufirin dhe Migracionin. Nderkaq, lidhur me lejet e punes, ju lutem referojuni linkut https://e-albania.al/eAlbaniaServices/DPPSH/15146/15146_LU_Documets.pdf . Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 74 | 26.04.2023 | Kërkesë për informacion për biznes | 27.04.2023 | Hello, For this kind of information you should contact at kontakt@issh.gov.al and tatime@tatime.gov.al . kontakt@issh.gov.al is the adress of the Institute of Social Insurance in Albania where you can ask about the pension and social insurance. tatime@tatime.gov.al is the adress of the General Directorat of Taxes in Albania where you can ask your other question. If you have any further questions please contact us at our official web adress https://www.adisa.gov.al/ on the online chatbox . Thank you. | E plotë | Nuk ka |
| 75 | 26.04.2023 | Kërkesë për informacion për portalin e-albania | 27.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se Kjo problematike s'ka lidhje me ne. Ju mund te dërgoni email në adresën helpdesk@e-albania.al në lidhje me problematikën tuaj. Për cdo pyetje mund te na kontaktoni përsëri.Faleminderit ! | E plotë | Nuk ka |
| 76 | 26.04.2023 | Shpallje martese midis një shtetasi shqiptar dhe një shtetasi të huaj | 27.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se hapi i parë i lidhjes së marteses, është shpallja e martesës. Procedura për të bërë shpalljen emartesës midis një shtetasi shqiptar dhe një shtetasi të huaj është si më poshtë vijon : Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar: certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile; dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese);<br>dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; fotokopje e dokumentit të identifikimit; Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë<br>pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm: certifikatë lindje; certifikatë lindje me shënimin "për lidhje martese"; Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikate martese/ekstrakt<br>akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Lidhur me pyetjen tuaj per dokumentat e partnerit tuaj, ato jane dokumentat qe nevojiten. Mund ti krahasoni dhe me sa me siper. Pra jeni ne rregull. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në chatbox online ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/ . Faleminderit! | | |
| 77 | 27.04.2023 | Kërkesë për informacion për Licensë për Laborator Dentar | 27.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije se duhet të aplikoni nga llogaria e biznesit në e-albania shërbimin "Aplikim për licencë të re në qendrën kombëtare të biznesit" nb kinkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=4607 Licencat për të cilat mund të aplikohet online janë 37 licenca të Grupit I dhe II, dhe njëra nga licencat është: II.6.A.1 - Shërbime laboratorike - Laborator dentar Personi fizik/juridik dhe/ose OJF kryen aplikimin online për pajisjen me licencën përkatëse; QKB-ja shqyrton kërkesat sipas radhës së paraqitjes së tyre dhe merr vendim në një afat prej 4 ditësh pune nga data e paraqitjes së | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kërkesës; QKB-ja shqyrton edhe paraqitjen e të gjitha dokumenteve provuese; Vlerësimi i përmbushjes së kritereve të licencimit/autorizimit/lejimit bazohet vetëm në vetëdeklarimet dhe në dokumentet provuese, të paraqitura nga kërkuesi. QKB-ja shqyrton kërkesën dhe merr vendim në një afat prej 4 ditësh pune nga data e paraqitjes së kërkesës. Me marrjen e njoftimit për miratimin e kërkesës, subjekti duhet të paraqitet pranë sporteleve të QKB-së dhe të paraqesë versionin original të dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit online. Gjithashtu në këtë moment subjekti bën edhe pagesën e tarifës së shërbimit të QKB-së prej 100 lekësh. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 78 | 27.04.2023 | Kërkesë për informacion për prokurë të posacme | 27.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, bëjmë me dije se pasi aplikoni shërbimin në e-albania, dhe pas verifikimeve të nevojshme të kryera nga përfaqësues të ambasadës/konsullatës, pranohet aplikimi dhe aplikanti ftohet më pas të ndjekë procedurat për të kryer pagesën dhe për të dërguar mandatin origjinal (jo fotokopje) me postë. Qytetari është i detyruar të paraqitet në përfaqësi për të firmosur në prezencë të konsullit procesverbalin e dorëzimit të kërkesës dhe për të dorëzuar dokumentet origjinale. Sigurohuni që adresa email që jeni regjistruar në portal të jetë aktive, pasi aty Ju mbërrijnë faturat dhe njoftimet nga konsullata. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 79 | 28.04.2023 | Kërkesë për informacion për Lëshim vërtetimesh Negativ/Pozitiv | 28.04.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nuk është detyrim ngarkimi i mandat pagesës, pasi fatura me të cilën keni paguar është shkarkuar nga sistemi në fund të aplikimit tuaj dhe mban barkodin e këtij aplikimi. Gjithsesi ju mund të gjurmoni aplikimin, dhe nëpërmjet gjurmimit, shikoni statusin e aplikimit që kalon nga statusi Arka, tek Specialist, Jurist, apo Shef zone. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 80 | 28.04.2023 | Kërkesë e paplotë për informacion | 28.04.2023 | Përshëndetje, Duke qene se kerkesa juaj për informacion është specifike, Ju lutemi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 për tju sqaruar më tej për rastin tuaj. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |